10/205/42100/30/14770/0443	Ministria e Mbrojtjes, Planifikimit dhe Mbrojtjes	Ndërtimi dhe reja të rrugëve	14770	Unaza e jashtme në Ferizaj (Përfaqësimi i Jerrive-Kosine-Libza-Drenas-Nerodime)	576,700.00
10/205/42100/30/14769/0443	Ministria e Mbrojtjes, Planifikimit dhe Mbrojtjes	Ndërtimi dhe reja të rrugëve	14769	Zgjerimi i rrugës Komogllave-Terzënik për më tejgjes Qarkosh (Ferizaj-Ve)	119,609.00
10/205/45000/30/15050/0160	Ministria e Mbrojtjes, Planifikimit dhe Mbrojtjes	Departamenti i Transportit Tokësor	15050	Ndërtimi i Vendeve të Autobusëve	739,258.00
10/205/60000/30/18249/0520	Ministria e Mbrojtjes, Planifikimit dhe Mbrojtjes	Autoriteti Rajonal i Përfijëve Lumore	18249	Rregullimi i shtrimit dhe zonave të degraduara të Lumit Desivo	40,000.00
Total Ndarjet në MPH					3,866,923.00

Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit

BLOKU KODUES	ORGANIZATA	PROGRAMI	PROJ	PROJEKTI	Shuma
10/207/80200/30/12425/0810	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ARRITJET SPORTIVE	12425	RENOV POLIG SPORT SHKOLL + polad	60,000.00
10/207/80200/30/13455/0810	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ARRITJET SPORTIVE	13455	NDERTIMI I SHITGJEVE TE ATLETIKES NE STADIUMET F	14,602.00
10/207/80200/30/14305/0810	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ARRITJET SPORTIVE	14305	NDERTIMI I FUSHAVE TE TENISIT NE KOMUNA TE NDR	1,000.00
10/207/80200/30/15100/0810	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ARRITJET SPORTIVE	15100	NDERTIMI I STADIUMIT TE QYTETIT NE PEJE	1,000.00
10/207/80200/30/15102/0810	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ARRITJET SPORTIVE	15102	PALESTRAE SPORTIT NE SHITME	1,000.00
10/207/80200/30/15105/0810	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ARRITJET SPORTIVE	15105	NDER SALLES ED FITKES NE SHK. HYSNI ZAJMI NE VR	3,373.00
10/207/80200/30/15376/0810	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ARRITJET SPORTIVE	15376	NDERTIMI I QENDRES NACIONALE TE XHUDOS PEJE	4,473.00
10/207/80200/30/15377/0810	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ARRITJET SPORTIVE	15377	RENOVIMI I STADIUMIT TE FUTBOLLIT NE KOMUNEN E	1,000.00
10/207/80200/30/18305/0810	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ARRITJET SPORTIVE	18305	NDERTIMI I STADIUMIT NE ZHUR PRIZREN	1,000.00
10/207/80200/30/18718/0810	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ARRITJET SPORTIVE	18718	PERFUNDIMI I PUNIMEVE NE STADIUMIN E QYTETIT NE	1,000.00
10/207/80200/30/18718/0810	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ARRITJET SPORTIVE	18718	NDERTIMI I QENDRES NACIONALE TE TENISIT TE KOSI	1,000.00
10/207/80200/30/18755/0810	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ARRITJET SPORTIVE	18755	PALESTRA SPORTIVE NE LIPJAN	3,970.00
10/207/80200/30/18755/0810	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ARRITJET SPORTIVE	18755	PUNIMET FINALE NE PALESTRËN "BEDRI PEJANI" PEJE	35,064.00
10/207/80300/30/06097/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	PËRKRAHJA INSTITUCIONALE PËR K	06097	REKUZITA SPORTIVE	11,628.00
10/207/80300/30/18716/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	PËRKRAHJA INSTITUCIONALE PËR K	18716	OBJEKTI TEATER DHE OPER DR IBRAHIM RUGOVA	1,000.00
10/207/80300/30/18762/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	PËRKRAHJA INSTITUCIONALE PËR K	18762	RENOVIMI I KULTURËS NE DRENOC, DECAN	16,137.00
10/207/80700/30/15874/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ZHVILLIMI DHE PËRKRAHJA RINISË	15874	QENDRA REKREATIVE RINORE NE FSHATIN PIJETERSH	35,212.00
10/207/81500/30/12688/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	12688	MASAT PREVENTIVE, INTERVENIME EMERGJENTE	29,415.00
10/207/81500/30/14571/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	14571	MUZEU I NATYRES /STUDIUMI I FIZIOLITIT DHE PROJ	1,000.00
10/207/81500/30/15111/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	15111	QENDRA HISTORIKE E PRIZRIT	20,000.00
10/207/81500/30/18112/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	18112	KOMPLEKSI ETNOLOGJIK "EMIN GJUK"	11,500.00
10/207/81500/30/15120/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	15120	KULLA NE OROBERDE I ISTOG	15,432.00
10/207/81500/30/15520/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	15520	SHTIEPIA E FAM LIES KORUGLU NE MITROVCE	1,000.00
10/207/81500/30/15625/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	15625	KISHA KATOLIKE NE FERIZAJ	75,000.00
10/207/81500/30/15629/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	15629	QENDRA HISTORIKE E PRISHTINES	1,000.00
10/207/81500/30/15630/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	15630	REZIDENCA ISLAM RUGOVA	50,000.00
10/207/81500/30/15631/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	15631	MUZEU SHTIEPIA E PAVARESISE	1,000.00
10/207/81500/30/15632/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	15632	FSHATI HOCE E MADHE	1,000.00
10/207/81500/30/15677/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	15677	FSHATI ZYM	1,000.00
10/207/81500/30/15678/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	15678	SHTIEPIA TRADICIONALE RYSHYT KEPUSKA, GJAKOVE	1,000.00
10/207/81500/30/15684/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	15684	MULLIRI DHE VELANCA E VISHEVE NE VERBAN, VITI	1,000.00
10/207/81500/30/15684/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	15684	SHTIEPIA E NMON FERIZIT, GJAKOVE	1,000.00
10/207/81500/30/15776/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	15776	KULLA E ETHEM GODENIT, ROGOVE	1,000.00
10/207/81500/30/15776/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	15776	KULLA E ZEQE RAVE SADRISË, BROVINE	1,000.00
10/207/81500/30/18215/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	18215	RESTAURIMI I AKADEMISE SE PARE USHTARAKE TE U	1,000.00
10/207/81500/30/18218/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	18218	NDERTIMI I KULLES TE SHABAN MANXHOLLIT NE FSH	20,000.00
10/207/81500/30/18218/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	18218	MUZEU ETNOGRAFIK NE GJAKOVE	20,000.00
10/207/81500/30/18374/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	18374	KULLA E FAM LIES GECI	15,000.00
10/207/81500/30/18378/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	18378	MUZEU ARKEOLOGJIK NE PRIZREN	17,664.00
10/207/81500/30/18460/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	18460	KULLA E ISA BOLETINIT	1,000.00
10/207/81500/30/18460/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	18460	RESTAURIMI DHE KONSERVIMI I KULLES SE SAHIT AVD	17,077.00
10/207/81500/30/18463/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	18463	ND KULL MUZEI I HEROIT TE KOVB BASRI C SHPENDI	34,819.00
10/207/81500/30/18765/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	18765	KULLA E SYLEJMAN VOKSHIT, GJAKOVE	15,971.00
10/207/81500/30/18766/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	18766	SHTIEPI BANIMI KURTESH SYLEJMANI, PRISHTINE	1,000.00
10/207/81500/30/18767/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	18767	SHTIEPI BANIMI MUSLI HOXHA, PRISHTINE	1,000.00
10/207/81500/30/18770/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	18770	SHTIEPI BANIMI SALIH SAGFI, PRISHTINE	1,000.00
10/207/81500/30/18774/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	18774	SHTIEPI BANIMI BUIAR XHULLI, PRISHTINE	4,000.00
10/207/81500/30/18774/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	18774	KULLA E ADEM OERM OSDAUTAJ	30,000.00
10/207/81500/30/15627/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	15627	NDERTIMI I KULLES MUZE REXHEP MALA, HOGOSHIT, H	30,000.00
10/207/81500/30/15927/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	15927	HAMAMI GAZI MEHMET PASHES, PRIZREN	40,000.00
10/207/81500/30/15928/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	15928	SHKOLLA JERONIM DERADA, FERIZAJ	30,000.00
10/207/81500/30/15929/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	15929	HAMAMI QYTETIT, MITROVCE	70,000.00
10/207/82000/30/00000/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	AGJENCIA SHITËTORE E ARKIVAVE	15929	LABORATORI PER KONSERVIMIN DHE RESTAURIMIN E	2,250.00
10/207/81300/30/00000/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	TEATRI KOMBETAR I KOSOVES	13	MALLRA DHE SHERBME	39,467.00
10/207/81300/30/00000/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	13	MALLRA DHE SHERBME	14,750.00
10/207/81600/30/00000/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	PREZENTIMET DHE KERKIMET PER T	13	MALLRA DHE SHERBME	4,687.00
10/207/82100/30/00000/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	BALETI KOMBETAR I KOSOVES	13	MALLRA DHE SHERBME	65,514.00
10/207/82300/30/00000/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	INSTITUTI ARKEOLOGJIK I KOSOVES	13	MALLRA DHE SHERBME	7,632.00
10/207/82500/30/00000/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	INSTITUTI I KOSOVES PER MBROJTJ	13	MALLRA DHE SHERBME	43,925.00
10/207/11307/30/00000/0850	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ADMINISTRATA QENDRORE	13	MALLRA DHE SHERBME	2,825.00
10/207/11407/30/00000/0850	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ZYRA E MNSTRIT	13	MALLRA DHE SHERBME	74,578.00
Total Kusimet MKRS					1,129,216.00

BLOKU KODUES	ORGANIZATA	PROGRAMI	PROJ	PROJEKTI	Shuma
10/207/80200/30/14163/0810	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ARRITJET SPORTIVE	14163	NDERTIMI I PALESTRES SPORTIVE NE DRAGASH	4,359.67
10/207/80200/30/14560/0810	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ARRITJET SPORTIVE	14560	PALESTRA SPORTIVE NE ZHEGER TE GJLANIT	59,450.00
10/207/80200/30/15104/0810	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ARRITJET SPORTIVE	15104	NDERTIMI I STADIUMIT TE QYTETIT NE DRENAS	24,753.03
10/207/80200/30/15378/0810	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ARRITJET SPORTIVE	15378	PISHNA OLMPIKE - PRIZREN	61.66
10/207/80200/30/15613/0810	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ARRITJET SPORTIVE	15613	STADIUMI QYTETIT NE LIPJAN	45,611.05
10/207/80300/30/14560/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	PËRKRAHJA INSTITUCIONALE PËR K	14560	RENOVIMI I STADIUMIT TE QYTETIT NE GJAKOVE	24,873.19
10/207/80300/30/15106/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	PËRKRAHJA INSTITUCIONALE PËR K	15106	RENOVIMI I SHTEPISË SE KULTURËS NE VITI	15,000.00
10/207/80300/30/18322/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	PËRKRAHJA INSTITUCIONALE PËR K	18322	QENDRA KULTURORE NE PAGARUSHINE	2,000.00
10/207/80700/30/14564/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	ZHVILLIMI DHE PËRKRAHJA RINISË	14564	QENDRA RINORE NE PODUJEVE	9,548.84
10/207/81500/30/14234/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	14234	KON RESTAR SHTE HINI PRISHTIN	6,820.00
10/207/81500/30/15385/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MEROJTJA RUAJTJA E TRASHËGIMISË	15385	RESTAURIMI DHE KONSERVIMI I KULLES SE FAZU BOG	16,214.91
10/207/81500/30/18426/0820	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORT				



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/52
Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Punëve të Brendshme e datës 16.12.2021, për pagesën e orëve shtesë të punës gjatë vitit 2021, në vlerë 513,872.89 € (pesëqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy euro e tetëdhjetë e nëntë cent), sipas listës së Ministrisë së Punëve të Brendshme për 766 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) zjarrfikësit e njësive nëpër Komunitat e Kosovës.
2. Për zbatimin e pikës 1. të këtij Vendimi, përdoren mjetet buxhetore në kategorinë e pagave dhe shtesave të organizatave buxhetore aty ku zjarrfikësit janë në listat e pagave në Sistemin e Pagave, mjete të cilat harmonizohen në nivel të kategorisë ekonomike me Vendim të veçantë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para përfundimit të vitit fiskal.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/52

Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 53 par.1 dhe nenit 55 par.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Vendimi Nr.03/117 i datës 22.01.2020, sipas të cilit z. Fidaim Sahiti, i vazhdohet mandati i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës edhe për 3 (tre) vjet, në qëllim të vendosjes së ligjshmërisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Vendimi Nr.03/117 nga par.1. i këtij Vendimi, është miratuar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/-149 Shërbimin Civil dhe aktet nënligjore përkatëse në shërbim të zbatimit të këtij Ligji. Vazhdimi i mandatit sipas nenit 22 par.1. të Rregullores Nr.06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nuk mund të interpretohet si mundësi e vazhdimit të njëpasnjëshëm, por vetëm si mundësi e vazhdimit të mandatit 1 herë, pas mandatit fillestar. Rrjedhimisht, me emërim në mandat të tretë, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datën 22.01.2020, përmes Vendimit Nr. 03/117 ka shkelur dispozitat e lartcekura.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë
- Z. Fidaim Sahiti



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/52
Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 42 paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit nr. 06/L- 114 për Zyrtaret Publik dhe nenin 14 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Znj. Fahrje Tërnavë-Sheremeti emërohet Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë katër (4) vjet.
3. E emëruara nga pika 1. e këtij Vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësit e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/52
Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 42 paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit nr. 06/L- 114 për Zyrtaret Publik dhe nenin 14 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Blerim Hasani emërohet Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë katër (4) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij Vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/52
Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Gjendjen Civile.
2. Obligohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/52
Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Shtetësinë.
2. Obligohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/52

Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për të Huajt.
2. Obligohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/52
Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë.
2. Obligohen Ministria e Ekonomisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/52

Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Tokën Bujqësore.
2. Obligohen Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 21/52
Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Fushën e Shpronësimit.
2. Obligohen Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 22/52
Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Task-Forca për Mbrojtjen e Tregut të Republikës së Kosovës ("Task-Forca") me këtë përbërje:
 - 1.1 Znj. Rozeta Hajdari, Ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, kryesuese;
 - 1.2 Z. Agron Llugaliu, Drejtor i Përgjithshëm i Doganës;
 - 1.3 Z. Ilir Murtezaj, Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore;
 - 1.4 Z. Flamur Kadriu, zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë;
 - 1.5 Znj. Lebibe Haliti-Bytyqi, zëvendësuese e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut;
 - 1.6 Z. Zef Dedaj, zëvendësues i Drejtor të Departamentit të Tregtisë në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
 - 1.7 Anëtar tjetër me ftesë të Ministres së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
2. Obligohet Task-Forca të vëzhgojë barrierat tregtare kundër Republikës së Kosovës dhe të propozojë masa për mënjanimin e tyre.
3. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë të kryejë shërbimet e Sekretarisë së Task-Forcës.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë
- Anëtarëve të Task-Forcës



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 23/52
Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohen Vendimi i Qeverisë Nr. 03/49 i datës 08.12.2020, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimet Nr.18/19, i datës 14.07.2021 dhe Nr.13/36, i datës 22.09.2021, si në vijim:
 - 1.1. Pika 1 (një) e Vendimit bazë Nr. 03/49 i datës 08.12.2020, ndryshohet ashtu që shuma e avancit të hapur, pas arsytimit të shpenzimeve për produktet e pranuar, reduktohet në 168,922.71 € (njëqind e gjashtëdhjetë e tetëmijë e nëntëqind e njëzet e dy euro, e shtatëdhjetë e një cent), shumë kjo e cila regjistrohet në SIMFK me kodin përkatës brenda vitit fiskal 2021, dhe bartet në vitin fiskal 2022.
 - 1.2. Pika 2 (dy) e Vendimit të Qeverisë Nr. 13/36, dt.22.09.2021, ndryshohet dhe plotësohet ashtu që afati i mbylljes së avancit të hapur shtyhet deri më datën 31.01.2022.
2. Pikat tjera të Vendimit të Qeverisë Nr. 03/49 të datës 08.12.2020 përveç atyre të përmendura në këtë Vendim, mbeten të pandryshuara.
3. Pjesë e Vendimit është shtojca 1. "tabela e shpenzimeve" bazuar në raportin e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS).
4. Obligohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh që faturat dhe pajisjet e porositura sipas procedurave të blerjes së pajisjeve mjekësore nuk mund të sigurohen sipas afatit të përcaktuar në pikën 2. të Vendimit të Qeverisë Nr.13/36, dt. 22.09.2021 në bazë të Marrëveshjes në mes Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës (MSH) dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS) e cila buron nga Ligji Nr.07/L-017 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me Financimin e Projektit Emergjent COVID-19 për Kosovën parasheh prokurimin e produkteve dhe pajisjeve mjekësore për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, marrë parasysh rregullat e disbursimit dhe prokurimit të Bankës Botërore të cilat janë pjesë e marrëveshjes së ratifikuar që cekin aranzhimet e veçanta të

projekteve me agjencitë e UN-it, mundësinë e pagesës në avanc si dhe në zbatim të nenin 13, Ligjit Nr. 07/L-041 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-041, si dhe kërkesën e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS) për shtyrje të afatit për mbyllje të avancit për pjesën e parë, si dhe raportin financiar të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve € (UNOPS) e pranuar nga Ministria e Shëndetësisë, nga shuma e avancit në vlerë prej 7,971,043.11€, janë shpenzuar 7,802,120.40 € dhe shuma e mbetur në vlerë 168,922.71€, do të shpenzohet gjatë janarit të vitit 2022, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 24/52
Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr.11/08, i datës 21.04.2021.
2. Pika 2 (dy) e Vendimit të Qeverisë Nr.11/08 të datës 21.04.2021 ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Shtyhet afati i mbylljes së avancit duke zgjatur afatin deri më 30.04.2022.
3. Pikat tjera të Vendimit të Qeverisë Nr.11/08 të datës 21.04.2021, përveç atyre të përmendura në këtë Vendim, mbeten të njëjta.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh që Marrëveshja në mes Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës (MSh) dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS) e cila buron nga Ligji Nr.07/L-017 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me Financimin e Projektit Emergjent COVID-19 për Kosovën parashih prokurimin e produkteve (pajisjeve/furnizimeve mjekësore) dhe intervenimeve infrastrukturore (renovime) për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, marrë parasysh rregullat e disbursimit dhe prokurimit të Bankës Botërore të cilat janë pjesë e marrëveshjes së ratifikuar që cekin aranzhimet e veçanta të projekteve me agjencitë e UN-it, mundësin e pagesës në avanc si dhe në zbatim të nenit 14, paragrafi 3. të Ligjit Nr. 08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 25/52
Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 14 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M


1. Plotësohet dhe ndryshohet pika 1. (një) e Vendimit të Qeverisë Nr. 07/10, të datës 30.04.2021, me ç'rast shuma e avancit të hapur, pas arsytimit të shpenzimeve për produktet e pranuar reduktohet në 730,935.07 € (shtatëqind e tridhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë euro, e shtatë cent), shumë kjo e cila regjistrohet në SIMFK me kodin përkatës brenda vitit fiskal 2021, dhe bartet në vitin fiskal 2022.
2. Plotësohet dhe ndryshohet pika e 2 (dy) e Vendimit të Qeverisë Nr. 07/10 të datës 30.04.2021, ashtu që afati i avancit të hapur zgjatet për një afat shtesë prej 6 muaj dhe do të mbyllet, përkatësisht arsyetohet nga Ministria e Shëndetësisë ashtu siç pranohen produktet/pajisjet e porositura dhe faturat sipas procedurave të blerjes së produkteve/pajisjeve, kryerjes së shërbimeve dhe ndërtimit të zinxhirit të ftohtë (Depos për ruajtjen e vaksinave), subjekt i kësaj marrëveshje, por jo me vonë se 30.06.2022.
3. Pjesa tjetër e Vendimit Nr. 07/10, të datës 30.04.2021 mbetet e njëjtë.
4. Obligohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh që Marrëveshja në mes Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës (MSH) dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS) dhe Amendamentin I të kësaj marrëveshje e cila buron nga Ligjin Nr. 07/L-030 për Ratifikimin e Marrëveshjes Kornizë për Kredi Ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Kosovës (BZHKE)-Instrumenti për Financim të Sektorit Publik për Reagim Emergjent ndaj COVID-19 nuk është përmblyllur brenda afatit të paraparë deri më 15 dhjetor 2021 për shkak të procedurave për marrjen e lejes dhe procedurat tjera të ndërtimit, bazuar në raportin financiar të Zyrës së

Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS) e pranuar nga Ministria e Shëndetësisë, nga shuma e avancit në vlerë prej 1,548,852.20 € , aktualisht të lira janë 730,935.07 € që barten si avanc i hapur në vitin 2022 dhe që do të shpenzohet gjatë vitit 2022, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 26/52
Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 14 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M


1. Aprovohet metoda e pagesës direkte (pagesë e njëhershme) në formë të avancit tek UNOPS, në emër dhe për llogari të Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe regjistrimi kontabël në SIMFK në kodin përkatës të avancit për pagesa direkte të huamarrjes, në vlerë prej 2,116,998.47 € (dy milionë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë euro, e dyzet e shtatë centë), si pjesë e dytë e avancit të dytë në bazë të Marrëveshjes Kornizë për Kredi të përcaktuara me Ligjin Nr. 07/L-030 për Ratifikimin e Marrëveshjes Kornizë për Kredi Ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Kosovës (BZhKE) - Instrumenti për Financim të Sektorit Publik për Reagim Emergjent ndaj COVID-19, si dhe bazuar në Marrëveshjen në mes Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës (MSh) dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS) të datës 01.04.2021 të amendamentuar (Amendamenti Nr.1) më datë 03.11.2021.
2. Avanci i regjistruar nga pika 1. e këtij Vendimi mbetet i hapur në një afat prej 6 muaj dhe do të mbyllet, përkatësisht arsyetohet nga Ministria e Shëndetësisë ashtu siç pranohen produktet medicinale dhe testet e porositura dhe faturat sipas procedurave të blerjes së produkteve medicinale dhe testeve të porositura, subjekt i kësaj marrëveshje, por jo më vonë se 30.06.2022.
3. Transferimi i mjeteve në formë të avancit nga pika 1. e këtij Vendimi, realizohet nga fondet e pranuar të kredisë nga BZhKE në llogarinë e përcaktuar në kuadër të Llogarisë së Vetme të Thesarit.
4. Autorizohet dhe obligohet Ministria e Shëndetësisë që të ndërmarrë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për zbatimin e kushteve të Marrëveshjes së ratifikuar me Ligjin Nr. 07/L-030 për Ratifikimin e Marrëveshjes Kornizë për Kredi Ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Kosovës - Instrumenti për Financim të Sektorit Publik për Reagim Emergjent ndaj COVID-19, si dhe bazuar në Marrëveshjen në mes Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës (MSh) dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS), datë 01/04/2021 të amendamentuar (Amendamenti Nr.1) më datë 03.11.2021.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Duke marrë parasysh që Marrëveshja në mes Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës (MSh) dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS) të amendamentuar e cila buron nga Ligji Nr. 07/L-030 për Ratifikimin e Marrëveshjes Kornizë për Kredi ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Kosovës (BZhKE)- Instrumenti për Financim të Sektorit Publik për Reagim Emergjent ndaj COVID-19 parasheh sigurimin e produkteve medicinale për trajtimin e COVID-19 në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (Tocilizumab, Remdesivir etj), në trajtimin e pacientëve me COVID-19 në Kujdesin Parësor Shëndetësor me produkte medicinale si dhe sigurimin e testeve për ekstrahim për nevojat e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe në zbatim të nenin 14, të Ligjit Nr.07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2021, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-016 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-041, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Pagesa e avancit sipas këtij Vendimi behet nga fondet e pranuar te kredisë nga BZhKE, te regjistruara ne SIMFK me fondin burimor përkatës, dhe për pagesën e avancit përdoren këto kode.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 27/52

Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 2.128 e Vendimit të Qeverisë Nr.02/50 i datës 23.12.2021, si vijon:

Udhëzimi Administrativ Nr.02/2012 për Tarifat e Përkohshme Noteriale, mbetet në fuqi deri në datën e hyrjes në fuqi të Udhëzimit të ri Administrativ për Tarifat e Noterëve, nxjerrë nga Ministria e Drejtësisë.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 28/52

Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-016, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19, të datës 14.07.2021, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin e Qeverisë Nr.12/31 të datës 25.08.2021 si dhe Vendimin e Qeverisë Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë prej 3,000,000.00 € (tre milionë euro), për zbatimin e Pakos së Ringjalljes Ekonomike për masën 4.6 - Mbështetja e Ndërmarrjeve Publike.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike, nën-programi "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet sipas pikës 1. të këtij Vendimi transferohen në Ministrinë e Ekonomisë me kod 213, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", në nën-programin "Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike" me kod 23300, për subvencionim të ndërmarrjeve publike.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë